



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

---

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**  
të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
19.03.2014, e cila filloi në orën 15:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës dhe u.d. i drejtorit të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit, Halim Halimi, kryesues, Sami Hamiti, Hazir Borovci, Ylli Hoxha, Hatixhe Hoxha, Islam Pacolli, Imer Rusinovci dhe Cuneyd Ustaibo.

**Morën pjesë edhe:** Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, Visar Berisha, Drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Pronës dhe përfaqësuesi i OSBE –së.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i komitetit.

Njëzëri u miratua ky

**REND DITE :**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë;
2. Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
3. Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ;
4. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2013 në vitin 2014;
5. Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës - Raporti përfundimtar përmbledhës buxhetor për vitin 2013;
6. Raportet e komisioneve komunale të aksionarëve – diskutim;
7. Propozimvendimi përfundimtar për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (i Vendimit 01 nr. 046-157056, të dt. 27.08.2013);
8. Propozimvendimi përfundimtar për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (i Vendimit 01 nr. 353-105896, të dt. 02.07.2013);
9. Informatë për gjendjen e furnizimit me ujë në komunën e Prishtinës;
10. Të ndryshme.

Para se të fillohet me diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, Dardan Sejdiu i njoftoi të pranishmit rreth vizitës të një delegacioni nga Zagrebi i drejtuar nga kryetari i Zagrebit, me

ç'rast ftoi subjektet e partive politike që të marrin pjesë në konferencën e forumit mes Zagrebit e Prishtinës.

### **Pika e parë**

**Dardan Sejdiu**, bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit, për pikën e gjashtë rreth shitjes së pronës së luajtshme të komunës, i cili tha se duhet të jetë: “në njërin nga mbledhjet e radhës të KPF-së do të sjellim listën e veturave të tjera për shitje”.

**Me vërejtjen e dhënë, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

### **Pika e dytë**

**Lidhur me Propozimvendimin për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës**, informoi **Agim Salihu**, i cili tha se, duhet të formohen edhe komitete tjera që janë edhe gjashtë (6) të përbëra nga nëntë(9) anëtarë, përbërja dhe kompetencat e komiteteve të cekura në pikën II të këtij vendimi, janë të përshkruara në dispozitat e nenit 6 të Rregullores për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve 01. nr. 110-1200, të dt. 16.6.2010.

**Ylli Hoxha** ishte i pajtimit që të jetë formula e proporcionalitetit që ta gjejnë një mirëkuptim se si të përfshihen anëtarët e komiteteve.

**Islam Pacolli** pyeti se a duhet të jetë i domosdoshëm me qenë përfaqësuesit i komitetit asamblastë apo mundet me qenë një profesionistë nga jashtë.

**Kryesuesi** tha se duhet të jenë 6 anëtarë nga kuvendi.

**Dardan Sejdiu** tha se anëtarë të komiteteve mund të jenë edhe nga jashtë, me qëllimin që edhe ata të kontribuojnë në komitet.

Në bazë të diskutimeve të parashtruara, mbetet që shefat e grupeve parlamentare ti sjellin emrat e anëtarëve të komiteteve.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

### **Pika e tretë**

**Lidhur me Propozimvendimin për themelimin e Komitetit konsultativ**, informoi **Agim Salihu**, duke shtuar se Komiteti konsultativ me propozimin e kryetarit është caktuar ti ketë 9 anëtarë nga qytetarë, përfaqësues të organizatave joqeveritare, të cilët janë njohës të fushvëprimtarisë së Komunës. Caktimi i anëtarëve në Komitetin konsultativ bëhet përmes shpalljes së konkursit publik, me mandat 3-vjeçar, me mundësi të përzgjedhjes edhe për një mandat

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për themelimin e komitetit konsultativ dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e katërt**

**Lidhur me Propozimvendimin për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2013 në vitin 2014 ,informoi Visar Berisha, drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, i cili ceku shumën e bartjes së mjeteve nga viti 2013në vitin 2014. Po ashtu paraqiti edhe pasqyrën tabelare me të dhëna më të detajuar.**

**Kryesusi** kërkoi që këtij materiali ti bashkëngjitet edhe një raport shtesë tekstual.

**Sami Hamiti**, bëri vërejtje duke thënë se, materialin nuk e klemi marrë me kohë, andaj sa i përket vendimit duhet të plotësohet me pjesën tekstuale se është vetëm vendimi me një tabelë dhe pjesë të mjeteve të bartura. Mendoj se pjesë e vendimit janë edhe tabelat, kështu që për Kuvend ky material të jetë me sqarime.

**Ylli Hoxha** e përkrahu parafolësin që materialet të dërgohen komplet dhe me kohë.

**Hatixhe Hoxha** tha se e përkrah këtë mendim që të kompletohet materiali dhe të përmirësohen gabimet teknike.

**Imer Pacolli** tha se materiali është i vonuar dhe jo kompletë,kërkoj që herëve tjera materiali të jetë komplet. Projektet që janë për këtë vit t'i shqyrtojmë që mos të shkoj sipas dëshirës (paushall). Po ashtu pyeti se a janë mjete të mbetura nga viti i kaluar.

**Sami Hamiti** tha se janë projektet që kanë shkuar dhe është fjala për bartjen e mjeteve të zotuar.

**Cuneyd Ustaibo** tha se pse të investohen aq mjete për Hamamin e Prishtinës, kur dihet se kjo trashëgimi kulturore është në shkatërrim sipër.

**Dardan Sejdiu** kërkoi që të bëhet raporti tekstual dhe korrigjimi i tabelave dhe që më pas të shkoj materiali në Kuvend.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2013 në vitin 2014 me plotësimin shtesë të materialit tekstualë dhe t'i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e pestë**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës - Raporti përfundimtar përmbledhës buxhetor për vitin 2013, që të finalizohet dhe të dërgohet për Kuvend për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e gjashtë**

**Lidhur me Raportet e komisioneve komunale të aksionarëve – diskutim,**

**Dardan Sejdiu**, informoi se disa ndërmarrje i kanë sjellë raportet e komisioneve komunale të aksionarëve disa jo, andaj mbetet që deri në fund të javës pritet që të sillen edhe raportet e tjera.

**U konstatua se njëzëri u përkrash që Raportet e komisioneve komunale të aksionarëve – diskutim të dërgohet për Kuvend për shqyrtim dhe miratim.**

**Pika e shtatë**

**Lidhur me Propozimvendimin përfundimtar për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (i Vendimit 01 nr. 046-157056, të dt. 27.08.2013), informoi Agim Salihu i cili tha se, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 26.8.2013, përmesë Vendimit të saj 01. nr. 046 – 157056, dt. 27.08.2013, e ka miratuar propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën në emër të: New company “Kosovashped”, Pjetër Palushi dhe Shkëlzen Noka, “Bingo Benz”, Ukshin Menxhiqi dhe në emër të Mefail Cakollit. Mbetet që tani këto propozimvendime ti procedojmë më tutje.**

**Kryesusi** tha se është mirë për mbledhje të Kuvendit ti bashkëngjitet edhe materiali tjetër shtesë.

**Ylli Hoxha** tha se sa i përket pronës për „Bingo Benz” kjo pronë ku mendohet të bëhet këmbimi është e kontestueshme, dhe propozoi që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, pasi që nuk vjen në shprehje një pronë kontestuese të votohet.

**Sami Hamiti** tha se ti analizojmë mirë këto çështje, të mbetet vendimi si këmbim në fuqi në parim e më pastaj të bëhet zgjidhje e pronës.

**Islam Pacolli** tha se jemi pr të bërë zgjidhje dhe se këtë çështje duhet ta shikojmë juridikisht.

**Dardan Sejdiu** tha se pasi ekziston një dokument i gjykatës se është në kontest kjo tokë, vendimi i pronës të mos revokohet. Për pronën që kemi menduar me këmbyer nuk është adekuate, duhet me shikuar një pronë tjetër.

**Ylli Hoxha** tha se për pronat tjera nuk ka marrë asnjë ankesë.

**Sami Hamiti** tha se për rastet tjera për Mefail Cakolli, Prishtinë dhe New company “Kosovashped”, Pjetër Palushi dhe Shkëlzen Noka ,në parim këto të votohen e për pjesën kontestuese mbetet që të shikohet.

**Hazir Borovci** tha se problemi është i pronës, kërkoj që atyre pronarëve ti ofrojmë mundësi për zgjidhje të pronës. Ne të marrim vendim komfortë ligjit, të mos i fusim njerëzit në konflikt.

**Ylli Hoxha** tha se është në dyshim edhe për dy rastet tjera andaj kërkoj nga Drejtoria e Financave dhe Pronës që të merr një vendim nga gjykata për pronat se a janë kontestuese.

**Islam Pacolli** tha se sa i përket pronës për „Bingo Benz” të hiqet, ndërsa për këto dy rastet tjera t’i shikojmë a janë kontestuese.

**Kryesusi** tha se me këtë çështje të merret Drejtoria e Financave dhe Pronës.

**Në bazë të diskutimeve të anëtarëve të Komitetit për Politik dhe Financa, obligohet përfaqësuesi juridik i Komunës që në bashkëpunim me Drejtorinë për Financa dhe Pronë, që deri në mbledhje e radhës së Kuvendit, rreth pronës së kontestuar ta hulumtojnë çështjen në gjykatë.**

## **Pika e tetë**

**Lidhur me Propozimvendimin përfundimtar për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (i Vendimit 01 nr. 353-105896, të dt. 02.07.2013), Agim Salihu dha sqarime lidhur me këtë propozimvendim.**

**Sami Hamiti** tha kjo pikë është specifike duhet të trajtuar mirë , se nuk është kundër një vendimi që është votuar. Unë e votoj këtë vendim dhe jam që t'iu bëhet zgjidhje këtyre njerëzve.

**Islam Pacolli** tha se nuk është për të dhënë tokë me tokë e Komuna mos të përfitoj asgjë, jam kundër këtij vendimi .

**Ylli Hoxha** tha se është shqetësuese qysh Komuna ka bërë një plan rregullues në kundërshtim me ligjin e monumenteve historike. Sipas vetvendosjes ky vendim është i gabuar. Po ashtu propozoi që ky vendim të hiqet prej rendit të ditës ,të merret një vendim që është në interes të përgjithshëm.

**Islam Pacolli** tha se duhet të bëhet një projekt dhe të shikohet çfarë përfitime ka komuna në atë objekt.

**Në bazë të diskutimeve të anëtarëve të Komitetit për Politik dhe Financa u konstatua se u përkrah Propozimvendimi përfundimtar për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (i Vendimit 01 nr. 353-105896, të dt. 02.07.2013), që të shkoj në Kuvend për shqyrtim dhe miratim, por mbetet çështje e hapur që Kryetari të propozon se si të procedohet më tuje kjo lëndë.**

## **Pika e nëntë**

**U konstatua se njëzëri u përkrah informata për gjendjen e furnizimit me ujë në komunën e Prishtinës dhe propozoi që lënda të dërgohet për kuvend për shqyrtim dhe miratim.**

## **Të ndryshme**

**Ylli Hoxha** propozoi që, Kuvendi të kërkoj nga Kryetari formimin e një komision prej 3 anëtarëve, që do të merrej me çështjen e mediave.

*Mbledhja përfundoi në ora 17:30.*

**Procesmbajtës :**  
**Zijadin Gashi**  
**Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Halim Halimi**